




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-1268/14
 Dep. 02 Br. Prot. 02-04-2014
 Nr. i faq. 02 Datum 02-04-2014
 Broj stranica 02 Data 02-04-2014
 Nr. pages 02 Date 02-04-2014
 PRISTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Ne mbështetje të nenit 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11) të Rregullores nr.02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.03.2014, mori :

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK– 03-3052/13, për, z. Muhamet Spahiu, Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Buxhet ne Komunën e Suharekës, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, pasi që zyrtari në fjalë nuk ushtron me funksion publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK–03-3052/13 që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Muhamet Spahiu, Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Buxhet ne Komunën e Suharekës, ku është dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit në ushtrimin e Funksionit Publik si, Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Buxhet ne Komunën e Suharekës, dhe angazhimit të tij në veprimtari tjera private si pronarë dhe person i autorizuar në bizneset private me emër N.SH “Alpha.com”, dhe “Ndriqimi ING” shpk.

Pas analizimit të gjendjes është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, pasi që z. Muhamet Spahiu, nuk është me duke e ushtruar pozitën e Drejtorit për Ekonomi, Financa dhe Buxhet ne Komunën e Suharekës, dhe nuk e ka me statusin e zyrtarit të lartë publik sipas ligjit në fuqi, ky fakt dëshmon se nuk kemi gjendje me elemente të konfliktit të Interesit dhe nuk kemi

situatë që dëshmon se ka shkelje të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrim të funksionit publik.

Duke vlerësuar gjendjen faktike dhe rethanat e krijuara pasi ka filluar trajtimi i këtij rasti konstatohet se nuk ka elemente që dëshmojnë gjendjen e Konfliktit të Interesit, pasi që z. Muhamet Spahiu, nuk ushtron funksion publik dhe nuk e ka statusin e zyrtarit të lartë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

